



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3250 / 6 prot.

B. Curri, më 10 . 09 . 2025

VENDIM

Nr. 48 , datë 04.09. 2025

"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE BASHKIA TROPOJË"

Këshilli i Bashkisë Tropojë, bazuar në Ligjin nr. 10463, datë 22/09/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", neni 12 dhe neni 13 (i ndryshuar); Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore (i ndryshuar); Ligjin nr. 10431/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", (i ndryshuar) ; Ligjin nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; Ligjin nr.8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave"; VKM nr. 418/2020, "Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035"; VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", VKM nr.418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; VKM nr.608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"; VKM nr.319, datë 31.05.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"; VKM nr. 402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve"; VKM nr. 957 datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"; VKM nr. 452, datë 11.07.2012 "Për landfillin e mbetjeve" (i ndryshuar) ; Urdhër nr.120, datë 18.07.2025 "Për caktimin e komisionit për hartimin e Planit Menaxhimit të Mbetjeve Urbane 2025-2030".

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Tropojë 2025-2030 sipas dokumentit të planit të bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Tropojë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 55, pika 6 (i ndryshuar).

Shpallur me 08.09.2025, Miratuar me 11 Vota, Vota 11 Pro, Vota 0 Kunder, Vota 1 Abstenim

SEKRETARI

Ergent GJONGECAJ

KRYETARI

Arber ÇAKRAJ